



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Agjencia Qendrore e Prokurimit-Centralna Agjencia Nabavke-Central Procurement Agency

KONTRATË PËR FURNIZIM

TITULLI I KONTRATËS: ANEKS KONTRATË NR. 1

Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira, Kategoria II

LOT I & II

NUMRI I PROKURIMIT: AQP / 17 / 006/1 / 111-5-1

Për kontratë: **Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira - Kategoria II, Lot 1 & 2** - Numri i Prokurimit: **AQP / 17 / 006/1 / 111**; Numri rendor i kontratës: **008/2017 DPQ LOT 1 & 2**.

Agjencia Qendrore e Prokurimit, Ndërtesa e Gërmisë, Zona A - Kati IV , Prishtinë (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

Auto Mita SH.P.K numri i biznesit: **70841932**, **Magjistranja Prishtinë Shkup km 7, Preoc** (në vazhdim "Furnizuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar si në vijim:

- Duke pasur parasysh se palët e përmendura më lartë kanë lidhur kontratë për aktivitetin e prokurimit "**Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira - Kategoria II - LOT 1 & 2**, me Numër të Prokurimit: **AQP / 17 / 006-1 / 111**, me datë 24.10.2017, dhe bazuar në kërkesat e shumta të parashkuara nga Autoritetet Kontraktuese/Njësitë Kërkuese, dhe Udhëzuesin Administrativ **06/2018**, aprovuar nga Qeveria e Kosovës me datën 27.03.2018., lidhet aneks kontrata edhe për një numër të automjeteve që paraprakisht marrin konfirmim me shkrim nga Autoritetet Kontraktues/Njësitë Kërkuese, por jo më shumë se 10% të automjeteve të cekura në kontratën bazë, që do të thotë, njëzet (20) por jo më shumë automjete, në vlerën prej 458,040.00 Euro.

Teksti i Nenit të ri të ndryshuar

Lënda e kontratës do të jetë "**Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira nga Furnizuesi**", në vijim: përshkrimi i përgjithshëm i furnizimeve, duke përfshirë sasi të total të dy pjesëve 204 automjete apo sipas LOT-eve. Kjo sasi mund të shtohet deri në njëzet (20) automjete.

Të gjitha dispozitat tjera mbesin të pandryshuara. Ky amendament do të jetë pjesë integrale e kontratës bazë dhe hyn në fuqi me nënshkrimin nga të dy palët.

Aneks Kontrata është përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe, në tri origjinale. Dy origjinale për Autoritetin kontraktues dhe një origjinal për Furnizuesin.

PALËT KONTRAKTUESE.

Për Autoritetin Kontraktues:

Emri: Ekrem Rexha

Pozita: Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Nënshkrimi: 

Vula:

Data: 01.06.2018



Për Furnizuesin:

Emri: *Lisjete Mita*

Pozita: *Financier*

Nënshkrimi: 

Vula:


Data: 01.06.2018



Për Autoritetin Kontraktues (ZKA):


Emri: Behxhet Rrukiqi

Pozita: Zyrtar Kryesor Administrativ

Nënshkrimi: 

Vula:

Data: 01.06.2018



Deklaratë e garantuesit

**SIGURIMI I EKZEKUTIMIT
POLICA NR. 070011240003339**

Për: AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT
(në vazhdim: "autoriteti kontraktues")

Në emër të: AUTO MITA SH.P.K
(në vazhdim "tenderuesi")

Titulli i prokurimit: Shfrytëzimi afatgjatë i automjeteve me qira

Numri i Prokurimit: UA/2016-18-2619-215

Garancion me kërkesë të pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues.

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitoi sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e Tenderit

DHE NGASE jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtënëshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej 45,804.00 € Katerdhjete e Pesemije e Teteqinde e Kater Euro zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim :

- Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutoi kontratën e nënshkruar, dhe si rezultat i sajë kanë mbet pa u paguar shumë punëtor, nënkontraktor dhe / ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej 45.804,00 € siç është thënë më lart, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa ma shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Kjo siguri vlen deri me datën 30.11.2023


Nënshkrimi dhe vula e garantuesit
Kompania e Sigurimeve "SIGURIA"
Emri i institucionit financiar

Adresa: Rr. Luan Haradinaj Llamella A, Prishtine

Data: 01.06.2018